

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B.H., nga Prishtina, përfaqësuar nga B.B, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit (IPK), të cilin e përfaqëson me autorizim N.A., zyrtare e lartë ligjore në Ministrinë e Drejtësisë - Divizionit për Përfaqësime Gjyqësore, për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin në punë, lidhur me revizionin e të paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1858/2015, datë 21.12.2015, në seancën e mbajtur më 12. maj 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurit (IPK), paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1858/2015, datë 21.12.2015, përkitazi me anulimin e vendimit të Komisionit për ankesa të IPK, nr. ..., datë ..., për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit dhe vendimit të IPK, nr..., datë ..., për sa i përket largimit të paditësit nga marrëdhënia e punës dhe detyrimit të të paditurit IPK për ta kthyer atë në vendin e mëparshëm të punës.

II. PRANOHET pjesërisht revizionin e të paditurit IPK dhe prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1858/2015, datë 21.12.2015 dhe ai i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr. 3017/2013, datë 27.02.2015, për sa i përket njohjes së të gjitha të drejtave të paditësit nga marrëdhënia e punës, kurse lënda lidhur me këtë pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 1858/2015, datë 21.12.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, C.nr. 3017/2013, datë 27.02.2015, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është

miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.H.. Me pjesën II të dispozitivit është vërtetuar se procedura disiplinore dhe vendimi i Komisionit për Ankesa të IPK, nr. ..., datë ..., me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, është në kundërshtim me ligjin dhe aktet e brendshme të IPK. Me pjesën III të dispozitivit është anuluar vendimi i IPK, nr. ..., datë ..., për largimin e paditësit nga puna. Me pjesën IV të dispozitivit është detyruar IPK që, në afatin kohor prej 7 ditësh, paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, përfshirë pagat dhe benefitet e tjera nga marrëdhënia e punës. Me pjesën V të dispozitivit, është detyruar i padituri që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 391 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri ka paraqitur revizion brenda afatit ligjor, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni i të paditurit është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, prej datës 01.05.2007 deri në datën 19.07.2013, kur u suspendua nga puna, ka qenë punonjës i Inspektoratit Policor të Kosovës. Nga themelimi i marrëdhënies së punës tek i padituri, paditësi ka qenë i notuar me cilësimin “shumë mirë” për rezultatet e arritura në punë. Në datën 19.07.2013 paditësi dhe kolegu i tij, B.R., ishin nisur me detyrë për në Gjilan dhe, për racionalizimin e shpenzimeve e me urdhër të mbikëqyrësit, atyre u ishte bashkuar edhe kolegu Q.V., i cili zyrtarisht do të duhej të shkonte në Ferizaj. Me urdhër të mbikëqyrësit, paditësi së pari kolegun Q.V. e dërgon në Ferizaj, pastaj me kolegun e vet, B.R., nisen për në Gjilan. Ndërkohë, rreth orës 13:00, V.O., drejtoreshë për hulumtime speciale, merr një telefonatë me të cilën njoftohet se njëri nga hetuesit e IPK, Q.V., momentalisht gjendet në motelin “F.”, në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj, bashkë me një femër të panjohur.

Menjëherë pas kësaj, V.O. dhe J.A., drejtor i hulumtimeve, me autorizimin e eprorit ekzekutues, nisen drejt motelit ku, sipas informacionit, gjendej njëri nga hetuesit e IPK. Para takimit, ata e hasin një veturë, të cilën, sipas dukjes, e drejtonte Q.V. Atëherë J.A., drejtor për hulumtime, e thërret atë me telefon dhe e pyet se ku gjendet, Q. Dhe merr përgjigjen se ndodhet në Ferizaj, duke kryer ca punë, kurse hetuesi tjetër, B.H., dhe B.R., gjenden në Gjilan. J.A., po në

atë çast i telefonon edhe B., duke e pyetur se ku dhe me kë ndodhej. B i thotë se nuk po ndihej mirë dhe merr urdhër që menjëherë të kthehet në bazë. B. i përgjigjet se do të vinte menjëherë pasi të shkonte në Ferizaj e ta merrte Q., prej ku do të kthehej shpejt. Pas kësaj, B. i telefonon disa herë Q., i cili, sipas sugjerimeve të drejtorit A., nuk u përgjigjet thirrjeve. Nga deklarata e drejtorit J.A., dhe drejtoreshës V.O., rezulton se pyetjes së tyre nëse ishin që të tre së bashku, B.i është përgjigjur me “po”. Pas kësaj, B. i urdhërohet, nga ana e drejtorit që të shkonte në stacionin policor në Ferizaj, ku ndodheshin drejtori J.A., drejtoresha V.O dhe Q.V., të cilët i urdhërojnë paditësit të japë deklaratën, në të cilën do ta përshkruante atë ditë të punës.

Me vendimin e kryeshefit ekzekutiv të IPK-ës, datë 19.07.2013, paditësi është suspenduar nga puna deri në përfundim të procedurës ndaj tij. Kryshefi, me vendimin nr. 03-268, datë 02.08.2013, ka formuar komisioni disiplinor të përbërë nga: A.T., kryetar, V.O. dhe M.K., anëtarë, për zhvillimin e procedurës disiplinore ndaj paditësit.

Komisioni Disiplinor, në datën 16.08.2013 ka zhvilluar procedurë disiplinore ndaj paditësit dhe, në raportin përfundimtar nr. ... të datë ..., veprimet e paditësit i ka cilësuar si shkelje të detyrave të punës, parashikuar nga neni 5 par.1.32, neni 5 par.1.32 dhe neni 11 par. 1, pika 1.5 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/MPB-2011, kurse me vendimin nr. 03-269, datë 16.08.2013, (i cili i bashkëngjitet raportit përfundimtarë), paditësit i është shqiptuar masa disiplinore e largimit nga puna, duke i rekomanduar kryeshefit ekzekutiv që ta mbështetë këtë vendim.

Me vendimin e kryeshefit ekzekutiv dt. 16.08.2013 është miratuar vendimi i Komisionit Disiplinor, me të cilin paditësit i është shqiptuar masa e rëndë disiplinore e largimit nga puna.

Kundër vendimit të kryeshefit ekzekutiv të datës 16.08.2013, paditësi ka ushtruar ankesë në datën 22.08.2013. Me vendimin e Komisionit për ankesa, nr. 03/307, datë 18.10.2013, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është lënë në fuqi vendimi i kryeshefit ekzekutiv nr. 03-262, me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se procedura disiplinore ndaj paditësit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 26 par. 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/MPB-201 dhe me nenin 10 par. 3 të shtojcës (h) të Udhëzimit Administrativ nr. MSHB/DASHC 2003/04, pasi që në Komision disiplinor ka marrë pjesë V. O., e cila ka qenë edhe hetuese e rastit, si dhe me lëshimet në punën të Komisionit për ankesa, që

kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 38. par. 2 të Udhëzimit Administrativ 2003/2004, pasi që as paditësi, as mbrojtësi i tij nuk janë thirrur në seancën e shqyrtimit të ankesave.

Sipas gjetjeve të gjykatës së shkallës së parë, shkeljet që i ngarkohen paditësit janë plotësisht të pabazuara, për faktet se paditësi ka qenë me detyrë në Gjilan dhe as fizikisht dhe as objektivisht nuk ka mundur të dinte saktësisht vendndodhjen e kolegut të tij në Ferizaj, duke i shtuar kësaj edhe faktin se ai, si zyrtar, nuk kishte në përshkrim të vendit të punës detyrimin e çfarëdo përkujdesjeje ndaj kolegut të tij, Q.V. Shkeljet disiplinore, për të cilat paditësi është gjetur fajtor, në kuptim të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/MPB-2011, nuk janë të përcaktuara si shkelje të rënda disiplinore, prandaj vendosi që ta miratojë kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën e ankimore, duke pranuar si të drejtë konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur e ka pranuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit në pjesën që ka të bëjë me anulimin e vendimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimin e paditësit në punë.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, në këtë pjesë, nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të tilla që do të ndikonin në ligjshmërinë e tij. Sikurse të dy gjykatat e instancave më të ulëta, edhe kjo Gjykatë mendon se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit është i kundërligjshëm për faktin se vendimi i kontestuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit është marrë në kundërshtim me dispozitën e nenit 11 të udhëzimit administrativ, nr. 13/MPB-2011, “Për përcaktimin e shkeljeve, masave disiplinore dhe procedurës disiplinore ndaj punëtorëve të IPK-ës”, në të cilin përshkruhen shkeljet e rënda disiplinore, për të cilat punonjësit të IPK-ës mund t’i shqiptohet masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në kuptim të dispozitës së nenit 19.1.4 të Urdhëresës së sipërpërmendur. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, të dy gjykatat kanë vlerësuar drejt se veprimet e paditësit nuk mund të cilësohen si shkelje e rëndë e detyrave të punës,

parashikuar nga nenin 11.1.5 të Udhëzimit Administrativ, si kryerje e veprimeve të pahijshme, për faktin se nuk kishte raportuar te mbikëqyrësi i tij për largimin nga vendi i punës të kolegut dhe për mungesë sinqeriteti ndaj mbikëqyrësit me qëllim që të mbrojë kolegun, për të cilin ka qenë në dijeni se po kryente shkelje të detyrave të punës. Kjo për arsye se Komisioni disiplinor, me asnjë provë nuk ka vërtetuar në mënyrë të sigurt dhe bindëse që paditësi ka kryer shkeljet e detyrave të punës që i ngarkohen, për faktin se nuk është vërtetuar që paditësi të ketë pasur dijeni për atë që kolegu i tij, në një qytet tjetër, gjatë orarit të punës po kryente shkelje të detyrave të punës. Aranzhimi i udhëtimit për kryerjen e punëve zyrtare nuk ka qenë i përcaktuar nga paditësi dhe kolegu i tij, por nga mbikëqyrësi i tyre. Paditësi nuk ka pasur për obligim e as që ka mundur të dinte se çfarë po bënte kolegu i tij dhe ku ndodhej gjatë orarit të punës dhe as që ka pasur obligim të kujdesej se me kë po rrinte ai dhe ku po e kalonte kohën e parashikuar për kryerjen e detyrës zyrtare. Për këto arsye, paditësi pa bazë ligjore është shpallur fajtor për shkelje të detyrave të ngarkuara të punës, ashtu siç kanë vlerësuar me të drejtë të dyja gjykatat. Prandaj, parashtrimet në revizion se gjykatat e kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, janë të papranueshme

Gjykata Supreme, po ashtu, vlerëson se dy gjykatat kanë vlerësuar drejt se edhe procedura disiplinore ndaj paditësit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 26 par. 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 13/MPB-2011, respektivisht nenit 10.3 të shtojcës (h), në lidhje me nenin 36.2.4 të Urdhëresës, (dispozitë kjo që mund të zbatohet në mënyrë analoge edhe me rastin e komisionit disiplinor), për faktin se në Komision disiplinor ka marrë pjesë V.O., si anëtare e tij, ndonëse kishte qenë dëshmitare e ngjarjes dhe për këtë arsye do të duhej të përjashtohej nga puna e Komisionit, pasi objektiviteti i një anëtari të tillë do të mund të vihej në dyshim, ashtu siç ka vlerësuar drejt gjykata e shkallës së parë.

Po ashtu, Komisioni për ankesa, me vendimin nr. 03-307, datë 18.10.2013, me rastin e shqyrtimit të ankesës së paditësit nuk e ka respektuar dispozitën e nenit 38.4 të Urdhëresës administrative, meqenëse as paditësi, as mbrojtësi i tij nuk janë thirrur në seancën e shqyrtimit të ankesës së paditësit. Prandaj, janë të pabazuara parashtrimet në revizion se të dy gjykatat gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë vlerësuar se vendimi i Komisionit disiplinor dhe ai i Komisionit të ankesave janë në kundërshtim me procedurat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ.

Parashtrimet në revizion se Komisioni për ankesa nuk e ka thirrur paditësen në seancën e shqyrtimit të ankesës, për faktin se, sipas konstatimit të Komisionit, ankesa e paditësit ka qenë e paqartë dhe kontradiktore lidhur me vendimet e goditura, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk

përmbajnë referenca ligjore që ndaj paditësit të shmanget zbatimi i procedurave ligjore të përcaktuara me rregullore, ashtu siç theksohet pa bazë në revizion.

Objekt shqyrtimi ishin edhe parashtrimet se gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur parasysh faktin se paditësi kishte marrë edhe disa qortime gojore nga i padituri dhe se Komisioni disiplinor, me rastin e marrjes së vendimit, i ka vlerësuar të gjitha këto rrethana, por kjo Gjykatë vlerësoi se ato nuk janë me ndikim në marrjen e një vendimi më të favorshëm për të paditurin.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga dispozita e nenit 182 par 2 pika n) të LPK-së, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë të paqëndrueshme për faktin se në revizionin e të paditurit fare nuk jepen arsye në kuptim të ligjit, duke vënë në dukje se ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara të dispozitave të procedurës kontestimore, ndërsa gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur dhe brenda kufijve dhe shkaqeve të parashtruara në revizion (neni 215).

Parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi aktgjykimi nuk përmban arsye përkitazi me pretendimet ankimore, kjo Gjykatë i gjeti si të papranueshme, ngaqë aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me këto shkelje dhe, si i tillë, është i qartë dhe përmban arsye faktike e juridike për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me pjesën e refuzuese të revizionit, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Ndërkaq, aktgjykimet e lartpërmendura, në pjesën gjykuese me të cilën detyrohet i padituri që paditësin ta kthejë në vendin e punës me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës që i kishte pasur para largimit nga puna, përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 182.2 pika (n) të LPK, sepse aktgjykimi i shkallës së parë, si tillë, është i paqarët në dispozitiv dhe në kundërshtim me arsyetimin e dhënë, pasi në dispozitiv nuk është përcaktuar se cilat të drejta nga marrëdhënia i takojnë paditësit. Një aktgjykim i tillë nuk mund të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme. Edhe kërkesëpadia në këtë drejtim ka qenë e parregullt. Për shkak të këtyre shkeljeve thelbësor procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht.

Në rigjykim, lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë duhet të thirret pala paditëse për ta bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe, pas kësaj, të vërtetojë se cilat të drejta nga marrëdhënia e punës i

kërkon paditësi, kështu që, pas administrimit të provave të tjera që ndodhen në shkresat e lëndës dhe vlerësimit të drejtë të tyre, për këtë çështje të marrë një vendim të ligjshëm.

Nga sa u parashtrua dhe në pajtim me nenin 222 lidhur me nenin 223.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Rev.nr.124/2016, datë 12 maj 2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani